



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 250/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave në objektin publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 11.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 10.10.2013, rreth orës 12:00, anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, në objektin e shkollës fillore në Carralevë, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013 në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë pabaza dhe të trilluara, të gjitha pretendimet e deritanishme të LVV-së janë të natyrës së njëjtë dhe se këto veprime nuk janë bërë nga ana e aktivistëve të PDK-së dhe se nuk jemi përgjegjës për këto veprime. Sipas tyre nga informacionet e marra nga terreni LVV po keqpërdorin shenjat dhe simbolet e PDK-së, për ta dëmtuar Partinë Demokratike.

PDK i propozon PZAP-it që të hedhë poshtë pretendimet e LVV-së

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë PDK, ka dërguar edhe foto për heqjen e posterave nga objekti publik publike, konkretisht nga Shkolla Fillore në Carralevë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sepse me datën 10.10.2013, rreth ores 12:00, anëtarë të PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, në objektin publik, konkretisht në shkollën fillore në Carralevë ku me këtë veprim kanë shkelur nenin 33 pika b e LZP-se dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterin e kandidatit për kryetar komune nga radhët e PDK-së, është i vendosur në shkollën fillore të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se PDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në objektin e shkollës në Carralevë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit

120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 250/2013 më datën 25.10.2013.



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*